



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

Numri i lëndës: 2023:000762  
Datë: 05.06.2024  
Numri i dokumentit: 05785199

**C-IV.-14-6712**

*Ankuesi :*

**Xh B** nga Vitia ,të cilën e përfaqëson H L avokat nga Vitia.

**Kundër**

*E paditura :*

**N.SH “Agromorava ” -Viti**, e përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit, rr. “Dritan Hoxha”, Nr. 55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Manushe Karaçi, me dt.14 qershor 2023, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

- 1. APROVOHET pjesërisht** ankesa e paditëses si e bazuar dhe **NDRYSHOHET** vendimi i Autoritetit të Likuidimit të AKP-së nr.GJI035-0052 dt.03.10.2014.
- 2. OBLIGOHET** e paditura AKP, që ankueses **Xh B** në emër të kompensimit për paga të papaguara t’i paguaj **shumën prej 425.00€**, kurse pjesa tjetër mbi shumën e aprovuar **Refuzohet** si e pa bazuar.
- 3. Secila palë i bartë shpenzimet e veta.**

**Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me 27 tetor 2014, ankuesja dorëzoi në Dhomën e Posaçme, ankesë kundër Vendimit nr.GJI035-0052 dt.03.10.2014, të Autoritetit të Likuidimit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit (më tej Autoriteti i Likuidimit ose shkurt AL), me të cilin ka kërkuar kompensimin për pagat e pa paguara në shumë prej 2,550.00 €, nga NSH “Agromorava” Viti (në likuidim). Ankuesja pohoi

se ka punuar për NSH-në dhe se nuk iu është ndërprerë marrëdhënia e punës asnjëherë derisa AKP me letër pezullimin për shkak të shitjes së aseteve më ka njoftuar se përfundon punësimi për shkak të tepricës.

Ankesës i ka bashkangjitur këto prova: Specifikacionin mbi obligimet e pa paguara, Lajmin e publikuar në Koha Ditore, Konfirmimin e Policisë së Kosovës nr.128 dt.20.04.2011, Procesverbalin nr.107 dt.15.04.2011, Vendimin e atakuar të AL nr. GJI035-0052 dt.03.10.2014.

Me dt.04.11.2014 ankuesja e ka parashtruar në gjykatë një parashtrësë për përmirësimin e shumës së kërkuar.

Me dt.27.02.2023, gjykata lëshoj një urdhër për ankuesen me anë të së cilës kërkoj ankuesja që të bëjë dorëzimin e njoftimit të AKP për ndërprerjen e marrëdhënies së punës si dhe prova tjera me të cilat i mbështet pretendimet e saja ankimore. Ankuesja iu përgjigj urdhrit me dt.08.03.2023 me anë të parashtrësës dhe në gjykatë dorëzoi: Vendimin e atakuar të AL, Formulari e AKP, Specifikacion mbi obligimet e papaguara, Librezën e punës, Njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, Aktvendimin e Gjykatës së Qarkut Gjilan dt.01.03.2012 si dhe prova tjera të cilat i ka bashkangjitur në ankesën bazë.

Me dt.24.05.2023, e paditura parashtrroi përgjigje në ankesë, në të cilën pohoi se Autoriteti i Likuidimit ka kryer një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. E paditura pohoi se pretendimet e ankueses janë të parashkruara, pasi që në bazë të dispozitave ligjore, për të ndërprerë parashkrimin kërkesa duhet të ishte paraqitur në gjykatë apo ndonjë autoritet kompetente, brenda tre viteve nga momenti kur NSH pretendohet të mos ketë përmbushur obligimet e saj ndaj ankuesit që rrjedhin nga marrëdhënia e punësimit, e që është 3 vjet nga qershori i vitit 2008. E paditura propozoi që ankesa të Refuzohet si e pa bazuar.

### **Arsyetimi ligjor:**

Ankesa aprovohet pjesërisht si e bazuar dhe ndryshohet vendimi i kundërshtuar i Autoritetit të Likuidimit nr. GJI035-0052 dt.03.10.2014.

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par.1 pika 1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa e vërtetojnë atë dhe merr këtë aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 par. 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësas apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese),

ndërsa, par.3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Neni 14.1 i Rregullores së UNMIK- ut 2001/ 27 ( si ligj në fuqi në kohën e ofrimit të shërbimeve të punës) parasheh që: *“Pagat - rrogat paguhen: (a) të paktën çdo muaj; (b) punonjësit personalisht ose përmes transferit bankar dhe (c) të shoqëruara me dëftesën e pagesës”*. Neni 55.1 i Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 (si ligj në fuqi në kohën e nxjerrjes së vendimit) parasheh që: *“I punësuari ka të drejtë në pagë, e cila përcaktohet me Kontratën e Punës, në pajtim me këtë ligj, Kontratën Kolektive, Aktin e Brendshëm të Punëdhënësit”*.

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesja ishte një punëtor i NSH “Agromorava” - Viti. Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është çështja e parashkrimit të kërkesës së ankueses për kompensim për pagat e papaguara. E paditura e kundërshton kërkesën e ankueses duke pretenduar se e njëjta është parashkruar, me arsyetim se ankuesja nuk ka ndërmarrë ndonjë veprim me qëllim të ndërprerjes së këtij afati. E paditura nuk e ka kontestuar bazën e kërkesës dhe as lartësinë e shumës së kërkuar. Ankuesja, bazën e kërkesës së tij e mbështet në Librezën e punës, në Njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe si dhe në pohimet e saj të parashtruara në ankesë.

Nga Njoftimi mbi Ndërprerjen e Marrëdhënies së Punës e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesja ishte në marrëdhënie pune në NSH deri me dt.25.11.2005, kohë kur edhe u privatizua NSH-ja.

Me Librezën e punës të NSH “Agromorava”- Viti, vërtetohet se ankuesi ishte në marrëdhënie pune nga dt.01.09.1980 e deri me dt.25.11.2005.

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante dhe të bazuara njoftimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe Librezën e punës së ankueses, për të arritur në përfundim se ankuesja ka ofruar shërbime pune për NSH për periudhën se për këtë periudhë i takon kompensimi për paga të papaguara për periudhën prej një (1) viti. E paditura nuk ka dëshmuar të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesi nuk kishte ofruar shërbime pune për NSH në periudhën e lartcekur, apo se nuk i takon kompensimi për paga.

Me rastin e aprovimit të shumës në lartësi prej 425.00 €, gjykata është bazuar në faktin se lartësinë të cilën e ka kërkuar pala me ankesën e dt.27.10.2014, e paditura fare nuk e ka kundërshtuar në mbrojtjen e saj. Andaj, duke qenë se lartësia e kërkesës së palës nuk ishte kontestuese në mes të palëve në procedurë gjykata e morri si të besueshme, dhe ia fali besimin.

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Pretendimi i të paditurës se kërkesa e ankueses e tëra është parashkruar, nuk është plotësisht i saktë. Gjykata vlerëson se parashkrimi është ndërprerë me Njoftimin e dt.25.11.2005.

Me rastin e aprovimit të shumës në lartësi prej 425.00 €, gjykata është bazuar në kërkesën e ankueses ku e cila në formularin e kërkesës së dorëzuar pranë AL ka kërkuar shumën prej 2.550.00€ për periudhën kohore prej vitit 2004 deri në vitin 2010 e që i bie për gjashtë vite. Mirëpo bazuar në shkresat e lëndës ankueses i janë njohur pagat për vitin 2004 në shumë prej 425.00 €, me përjashtim të pagave të papaguara për vitin 2005-2010, të cilat janë refuzuar për shkak se ankueses i ishte ndërprerë marrëdhënia e punës në vitin 2005.

Gjykata vëren se njoftimi i datës 25.11.2005, është një njoftim i përgjithshëm për kreditorët potencial dhe kështoj nuk përcakton statusin individual të secilit ankues në kuptim të ekzistimit të marrëdhënies së punës dhe si e tillë nuk mund të shërbejë si e vetmja bazë për tu njohur të drejtën për paga të papaguara, por e njëjta duhet të shihet edhe në lidhshmëri me dëshmitë tjera, të dorëzuara nga ankuesja, siç është arsyetuar më lartë. Ankuesja me letrën e datës 25.11.2006 ishte njoftuar se punësimi i saj përfundon për shkak të tepricës dhe se çdo kërkesë eventuale që mund të ketë ndaj NSH, duhet ta parashtrijë me rastin e inicimit të procedurës së likuidimit ndaj NSH. Futja e NSH-së në procedurë të likuidimit në bazë të dispozitave ligjore ka qenë detyrë e të paditurës dhe nuk është varur nga vullneti i ankueses, kështoj ankuesja ka pasur prirje legjitime lidhur me fillimin e procedurës së likuidimit dhe parashtrimin të pretendimeve të tij kreditorë në po atë procedurë. Vonesa e fillimit të procedurës së likuidimit të NSH nuk mund ti atribuohet ankueses dhe kështoj ti mohohet e drejta në kompensim vetëm mbi faktin e afatit të parashkrimit, përderisa ka qenë obligim ligjor i të paditurës për fillimin e kësaj procedure dhe përderisa ankuesi me letrën e lartcekur është njoftuar se kërkesat kreditorë që mund ti ketë duhet ti parashtrijë kur të fillojë procedura e likuidimit. Njëherit një interpretim i tillë është në pajtim edhe me precedentët e DHPGJS-së dhe të Kolegjit të Ankesave (AC-I-20-0282, AC-I-20-0033, AC-I-20-0168 , AC-I-20-0183 etj).

Nisur nga kjo gjendje, gjykata vjen në përfundim se ankueses Xh B, kishte ofruar shërbime punë për NSH dhe kështoj i takon e drejta në kompensim për një vit për paga të papaguara në shumën e aprovuar.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

### **Shpenzimet gjyqësore**

Ndaj parashtruesit të ankesës nuk caktohet taksë gjyqësore ngase të njëjtën e ka paguar më dt.31.01.2023 në shumë prej 20 euro, sipas Udhëzimit Administrativ të Këshillit Gjyqësor të Kosovës nr. 01/2017 të datës 1 maj 2017 për Unifikimin e Taksave Gjyqësore.

## **Këshillë juridike**

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 par.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

**G J Y Q T A R J A**  
**Manushe Karaçi**